# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-439515**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Gjyqtarët, si partia e çekiçave”, Rama: Paguhen edhe më shumë se kolegët në Greqi. Vendimi i KLGJ dhe KLP absurd – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/gjyqtaret-jane-te-superpaguar-rama-marrin-me-shume-se-koleget-ne-greqi-jane-bere-vete-zot-vete-shkop/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 10:22:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 10:20:46 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8305b7ef5cd924882bea52511a5b9f6601c5d5a04b3f664ed00543763ed1100a` |
| TEKSTI | `5d5d1fff059bdb9c6b4549e3e90ea5ade9e303b7d716b235e027b144af899276` |
| PAMJA | `1ff1d8fe79980b1ba7a95211d35f831844457198cfca8b6e801f2b9026067459` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c43d14fa1babe4003e1dae336a1d9f5e6196bf895b71b3a75ba5ee9e69a8bafe` |
| E MËPARSHMJA | `cebe00b88179e0b629ba3463853d5d7c2bf9f78b18a028de82648c8b1e224399` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c43d14fa1babe4003e1dae336a1d9f5e6196bf895b71b3a75ba5ee9e69a8bafe`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

5 Starton Ferma Vip 2! Përballje, surpriza, debate dhe të papritura,...

Kryeministri Edi Rama ka vazhduar  debatin për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve në rrjetet sociale duke theksuar se askush nuk mund të kërcënojë pushtetet e pavarura siç janë ekzekutivi dhe legjislativi.

Mëngjesin e së dielës fillimisht kryeministri publikoi pagat e magjistratëve në 10 vende të Europës, duke vënë në dukje se me rritjen e re të rrogave gjyqtarët e prokurorët shqiptarë bëhen më të paguar se kolegët e tyre në Rumani, Greqi, Bullgari.

“Një gjykatës fillestar sot në Shqipëri merr 500 euro pagë më të lartë se sa kolegu në Greqi dhe me vendimin e marrë vetë Zot vetë Shkop, paga duhet të rritet 2000 Euro më shumë në muaj se sa kolegu grek dhe 3000 euro më shumë se sa kolegu në Malin e Zi”, tha Rama.

Pak më vonë, kryeministri Rama në një video të realizuar nga makina e tij sulmoi dy institucionet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe vendimin e tyre për të rritur pagat e magjistratëve

“Vendimi absurd marrë nga dy këshillat, që në letër janë organet qeverisëse të pushtetit gjyqësor, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, por që në realitet janë dy shëmbëlltyrat e anës së errët të medaljes së reformës në drejtësi”, tha kreu i qeverisë.

Kryeministri e përshkoi situatën e krijuar si vulgare duke i krahasuar gjyqtarët e prokurorët me një parti politike.

“Po pse, cfarë jeni ju, partia e “cekicave”, ato cekicat për cfarë i keni? Për

NEWSLETTER
Përmbledhja e ditës në e-mail
emaili juaj
Abonohu

parti? Për luftë politike dhe për të dalë e për të kërcënuar autoritetet kushtetuese dhe politike të Republikës së Shqipërisë? Për të kërcënuar ministrin e Financave? Për të kërcënuar drejtorët e Thesarit të Republikës së Shqipërisë? Pse, ça janë ata? Roje magazinash pa zot?", tha Rama.

Ndërkaq të hënën Komisionet Parlamentare nisin diskutimet rreth ndryshimeve ligjore që garantojnë rritjen e pagës për gjyqtarët e prokuroët.

Drafti është parashikuar fillimisht të kalojë kalon në Komisionin e Ekonomisë e pasi të kalojë edhe në Komisionin e Ligjeve të enjten ligji pritet të miratohet në seancë plenare.

Konflikti mes sistemit të drejtësisë dhe qeverisë nisi pasi Parlamenti nuk respektoi vendimin e Gjykatës Kushtetuese e cila në muajin shkurt urdhëroi Kuvendin që deri ne 31 korrik të miratonte një ligj që garantonte rritjen e pagës së gjyqtarëve e prokurorëve.

Në kushtet kur Parlamenti nuk veproi, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli I Lartë i Prokurorië miratuan rritjen e pagave për magjistratët, vendim ky që nuk është pranuar nga qeveria e ministria e Financave e cila ka bllokuar pagesat për gjyqtarët e prokurorët.

#rama


**Xhuljana Zhuleku**

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.


Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh




POLITIKË

**"Nuk po na lejohet të marrim nga qesja...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 21:49



POLITIKË

**"Të dëgjojmë dhe të trajtojmë çdo...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 20:03



POLITIKË

**Reforma Territoriale, Rama takim në Bera...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 19:44

## Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.